

INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR BANORËT/QIRAMARRËSIT MBI MBROJTJEN NDAJ ZJARRIT NË BANESË



ÇDO DITË DIGJEN 180 BANESA NË SUEDI

Shërbimi i shpëtimit nisesh shpejtë të 20 nga këto zjarre. 60 zjarre janë zjarre të përmasave të vogla, të cilat i shuajnë vetë banorët. 85-90 persona humbin jetën, çdo vit, kur digjen banesat dhe rreth 1000 persona lëndohen. Shkaku më i zakonshëm i shpërthimit të zjarrit është ushqimi i harruar mbi stufë/sobë, defekti elektrik, pirja të duhanit dhe qirinjtë e ndezur.



SINJALIZUES ZJARRI NË ÇDO BANESË

Çdo banesë duhet të ketë së paku një sinjalizues zjarri. Është me rëndësi që sa më shpejtë të zbulosh një zjarr. Pronari i ndërtesës ka për detyrë të instalojë një sinjalizues zjarri. Banori ka përgjegjësinë të ndërrojë baterinë. Ti, natyrisht, mund të blesh vetë një sinjalizues zjarri, me dëshirë, të jetë me bateri për pesë ose dhjetë vjet. Është mirë të kesh më shumë sinjalizues zjarri. Kontrollon rregullisht që sinjalizuesi i zjarrit funksionon, duke e shtypur butonin e testimit të çdo sinjalizuesi të zjarrit.



PAJISJE PËR SHUARJEN E ZJARRIT

Shërbimi i shpëtimit rekomandon të ketë një shuas zjarri me pluhur në të gjitha banesat. Një batanije zjarri është po ashtu mirë të kesh në shtëpi. Me batanije të zjarrit, mund të ngulfatësh zjarrin ose të zvogëlosh përmasat e një zjarri. Pajisjen mund të blesh në qendra të mëdha tregtare, qendra tregtare të ndërtimit ose përmes ndërmarrjes tënde të sigurimit



TYMI TË MBYT – PËRKUFIZO ZJARRIN

Nëse merr flakë banesa jote: paralajmëroj/sinjalizoj të gjithë ata që gjenden në banesë, përpiku të shuash zjarrin, pa rrezikuar vetën. Nëse nuk mund të shuash zjarrin, atëherë mbyll derën e asaj hapësire ku ka marrë flakë. Dil nga banesa dhe mbylle derën e jashtme, që të pengosh përhapjen e zjarrit dhe të tymit helmues. Tymi është i rrezikshëm për jetën e njeriut, dhe ai e mbyllë njeriun shumë shpejtë. Telefoni 112. Prite Shërbimin e shpëtimit para shtëpisë.



MOS DIL KURRË NË SHKALLË TË MBUSHURA ME TYM

Nëse ka marrë flakë një banesë tjetër ose digjet gjetiu në ndërtesë, atëherë ti duhet të rish në banesën tënde. Mos dil kurrë në shkallë të mbushura me tym. Ti je më i sigurt në banesën tënde. Mbyll dyert dhe dritaret. Telefoni 112. Shërbimi i shpëtimit ka pajisje speciale për të ndihmuar ty. Dera e jashtme, muret, tavani/çatia dhe dritaret e një banese duhet të i qëndrojnë zjarrit 30-60 minuta.



Nëse bie zjarri në banesën tënde:

**PËRKUFIZO ZJARRIN
LARGOHU NGA BANESA
TELEFONO 112**

Nëse bie zjarri gjetiu në ndërtesë:

**MOS DIL KURRË NË SHKALLË
TË MBUSHURA ME TYM!**

